



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

ORGANI KOMBËTAR I INVESTIGIMEVE  
TË AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE  
AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL

Nr. 3776/1 Prot. Datë 18.01.2012

Nr. 05 Prot. Datë 19.01.2012

Ex 11

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**Neni 1**

Ky Memorandum Bashkëpunimi, i lidhur midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Organit Kombëtar të Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, në vijim referuar (OKIIA), themelon parimet e bashkëpunimit midis tyre.

Palët në këtë Memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, Kodin Ajror dhe legjislacionin në fuqi.

**Neni 2**

Qëllimi i këtij memorandumi është sigurimi i bashkëpunimit në investigimin e aksidenteve dhe incidenteve ajrore, që bëhen shkak për fillimin e një hetimi penal nga organi i prokurorisë dhe investigimi nga Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore, duke shmangur një konflikt të mundshëm kompetencash, duke ruajtur pavarësinë dhe funksionin e Palëve, për të siguruar që ato të jenë të afta të kryejnë një investigim të saktë.

**Neni 3**

Palët pranojnë se ky Memorandum Bashkëpunimi nuk kufizon diskrecionin dhe kompetencat e secilës palë, bazuar në legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 4**

Qëllimi i investigimit të OKIIA është përmirësimi i sigurisë ajrore, duke mundësuar kryerjen e shpejtë të investigimeve, të cilat synojnë parandalimin e aksidenteve dhe të incidenteve në të ardhmen. Këto investigime nuk kanë për qëllim të caktojnë apo të ndajnë fajin dhe/ose përgjegjësitë.

#### **Neni 5**

Misioni i Prokurorisë është ushtrimi i ndjekjes penale, përfaqësimi i akuzës në gjyq në emër të shtetit, si dhe kryerja e detyrave të tjera të caktuara me ligj. Prokurori zhvillon në bazë të kompetencave të dhëna nga ligji, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

#### **Neni 6**

Palët do të bashkëpunojnë gjatë hetimit, për të realizuar detyrat respektive dhe për të përcaktuar kur është e mundur shkaqet e aksidentit apo incidentit ajror.

#### **Neni 7**

Me qëllim realizimin në mënyrën më efektive dhe brenda kohës më të shkurtër të mundshme, të investigimit të aksidentit apo incidentit ajror nga OKIIA, prokurori i ngarkuar me hetimet paraprake autorizon investiguesin në detyrë për secilin nga veprimet e mëposhtëme:

- a) të ketë hyrje të pakufizuar në vendin e aksidentit, të ngjarjes, në avion apo mbetjet ose përbërësit e tij;
- b) të ketë akses të menjëhershëm dhe të përdorë regjistrimet e fluturimit dhe regjistrime të tjera, për të siguruar një ekzaminim të hollësishëm në kohën e duhur, nga personeli i autorizuar investigues;
- c) të sigurojë një renditje të menjëhershme të provave dhe heqje të kontrolluar të mbetjeve ose përbërësve të avionit, për qëllime ekzaminimi dhe analize;
- ç) të ketë akses në rezultatet e ekzaminimit të trupave të viktimave ose të testeve të bëra nga kampionet e marra nga trupat e viktimave;
- d) të ketë akses në rezultatet e ekzaminimeve mjekësore të viktimave, nëse është e mundur, ose të testeve të bëra me kampione të marra nga këta persona;
- dh) të ekzaminojë dëshmitarët;
- e) të ketë akses në informacionet apo të dhënat e rëndësishme, që mbahen nga pronari, operatori apo prodhuesi i avionit, si dhe nga autoritetet përgjegjëse për aviacionin civil apo për operimin e aeroportit.

#### **Neni 8**

**1. Personi i kontaktit në OKIIA për zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi është:**

Një anëtar i Bordit / Inspektor

Rruga "Pashko Vasa", P.13/6, P.O.Box 74, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2244472

Fax: +355 4 2244473

Cel: +355 682021409

E-mail: [info@okia.gov.al](mailto:info@okia.gov.al)

**2. Personi i kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi është:**

Drejtori i Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale, në Prokurorinë e Përgjithshme

Rruga "Qemal Stafa", Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222022/1075

Cel: +355 694113871

E-mail: [amesareja@pp.gov.al](mailto:amesareja@pp.gov.al)

**3. Palët do të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim menjëherë për zëvendësimin e personit të kontaktit.**

**Neni 9**

Ky Memorandum hartohet në **6** (gjashtë) kopje të barazvlefshme, nga **3** (tre) për secilën Palë.

Palët rishikojnë këtë Memorandum Bashkëpunimi çdo **2** (dy) vjet.

**Neni 10**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHËM**



**INA RAMA**

**DREJTORI I PËRGJITSHËM I OKIIA**

**Ing. ARBEN XHIKU**

